



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt.03.02.2022]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “INET ALBANIA” shpk

Adresa: Tirane Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 3.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Ngritja e platformës për mbledhjen dhe anlizimin e të dhënave në funksion të një vendimmarrje sa më efikase në Institucion”** me Nr REF-16777-12-30-2021 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 192 datë 31 Dhjetor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “3i-Solutions” sh.p.k NIPT L52305007S

Vlera e ofertës pa tvsh = 24.840.000 (njëzet e katër milion e tetëqind e dyzet mijë) lekë

2. Operatori ekonomik “INET ALBANIA” sh.p.k NIPT K81607039F

Vlera e ofertës pa TVSH– 27.686.000 (njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë

Nga pjesëmarrësit është s’kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik “3i-Solutions” sh.p.k

NIPT L52305007S

Për arsyet e mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3., pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, “Kapaciteti Teknik” ka kërkuar:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, për të garantuar implementimin me sukses të projektit, si dhe garancinë e mirëmbajtjen përgjatë periudhës së parashikuar në termat e referencës bashkëlidhur, duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

...c. Të paktën 1 (një) punojës të diplomuar Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatike, Informatike Ekonomike ose Shkenca Kompjuterike dhe të çertifikuar në nivel ndërmarrës profesional për arkitekturë rrjeti (netëork) nga një çertifikues i njohur si (CCNP, CompTIA Netëork+ ose ekuivalent)”.

Operatori Ekonomik “3i-Solutions” sh.p.k në sistemin e prokurimit publik, për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, ka paraqitur si vijon:

- ✓ Diplomë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” me nr. 7962, për z.Stiven Toska
- ✓ Diplomë “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, profili “Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike” me nr.serial 000020 për z.Stiven Toska
- ✓ Certifikatë nga Cisco “Cisco Certified Netëork Associate” nr. 5DZMSBLFP34QQF58, për z.Stiven Toska
- ✓ Certifikatë përfundimi nga “UDEMY” për “CISCO CCNP Enterprise-200-401-ENCOR-Fast Track” për z. Stiven Toska

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur certifikatë “CISCO CCNP Enterprise-200-401-ENCOR-Fast Track” dhe verifikimi në site online, rezulton se lëshuesi i kësaj certifikate, (*Education Site*) “UDEMY”, nuk është certifikues i akredituar. Ndodhur, para këtij fakti nuk krijohet bindja për aftësitë e specialistëve të pajisur me këtë tip certifikate, dhe për më tepër nuk sigurohet garancia e kërkuar në përmbushje të kriterit si më sipërcituar, duke sjellë një rrisht të konsiderueshëm në mbarëvajtjen e projektit/kontratës dhe investimit në tërësi. Pavarësisht se “UDEMY” shërben si një platformë për mësimin online, duke qënë i paakredituar për të certifikuar, cdokush mund të certifikohet në fusha të caktuara për të cilën ofrohen trajnime prej “UDEMY”, por nuk krijon besueshmëri për punëdhënësit në përgjithësi dhe për më tepër për AK, i cili investon në një projekt me rëndësi strategjike si “Ngritja e platformës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në funksion të një vendimmarrje sa më efektive në institucion”. Pjesëmarrja në një kurs në “UDEMY” të shoqëruar me një certifikatë, tregon se është arritur një nivel i caktuar trajnimi në një kurs specifik, megjithatë, certifikata nuk është domosdoshmërisht në përputhje me standardet e kërkuara nga një punëdhënës/institucion/agjenci zyrtare qeverisëse apo standarde arsimore.

Një nga linket për referencë:

<https://www.randstadrisemart.com/blog/which-online-certificate-courses-are-credible-your-career-development#:~:text=Udemy%20is%20not%20considered%20an,improve%20skills%20you%20already%20possess>)

Gjithashtu, duke u bazuar në domosdoshmërinë e një sistemi të integruar për raportimin dhe digjitalizimin e procesit të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave, Bashkia Tiranë e konsideron këtë projekt tejet të rëndësishëm dhe strategjik. Sikundër është evidentuar në termat e referencës së projektit, krahas periudhës 4 mujore të zhvillimit të sistemit, kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për tërë kohëzgjatjen e kontratës (24 muaj). Për të minimizuar riskun e implementimit dhe përfundimit me sukses të kontratës, AK ka kërkuar specialist të certifikuar dhe me aftësi profesionale dhe teknike (sic është edhe kërkesa 2.3.3 (c), që të mund të garantojnë ecurinë e projektit, realizimin në kohë dhe me cilësi të elementëve specifikë që lidhen me aftësitë që përmbush certifikimi i kërkuar si dhe realizimin të termave të mirëmbajtjes dhe kontratës në tërësi.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar përmbushjen e këtij kriteri nga operatorët ekonomikë, duke siguruar dëshminë për aftësitë dhe kapacitetet teknike të stafit, përmes dokumentacionit të lëshuar nga certifikues të njohur, duke analizuar rëndësinë e tij edhe në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, si më poshtë:

“Duke qënë se sistemi do të integrohet në rrjetin e domeinit ekzistues të institucionit si dhe do të dizajnohet në formë të atillë për ti lënë mundësi bashkëpunimeve të vazhdueshme me sisteme të tjera në varësi të nevojshmërisë së institucionit, operatori ekonomik duhet të sigurojë të paktën një profesionit të certifikuar për zbatimin e teknologjive kryesore të ndërmarrjeve të rrjetit, duke përfshirë arkitekturën e dyfishtë (IPv4 dhe IPv6), virtualizimin, infrastrukturën, sigurimin e

rrjetit dhe automatizimin. Kërkesa për këtë certifikim gjithashtu dëshmon njohurit e stafit të kualifikuar në identifikimin dhe diagnostikimin e detajuar për çdo problem apo keqfunksionim të komponentëve të sistemit dhe propozimin për zgjidhje efikase në përmbushje të kërkesave të mirëmbajtjes për periudhën 2 vjeçare.”

Nisur nga sa më sipër cituar, dhe në kushtet ku “UDEMY” që ka lëshuar këtë certifikatë nuk krijon siguri për të qenë i besueshëm nga “punëdhënës”, në këtë rast nga AK nuk ofrohet garanci dhe besueshmëri për plotësimin e këtij kriteri nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, certifikata nga CISCO “Cisco Certified Network Associate” e paraqitur në përmbushje të kriterit 2.3.3 (c), nuk është në nivel ndërmarrës profesional, sikurse është kërkuar. Refruar fakteve të parashtruara, kriteri 2.3.3 (c), nuk përmbushet nga Operatori Ekonomik.

II. Në kriterin 2.3.3.(e) të Kapatitetit Teknik, AK ka kërkuar punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

“e. Për të garantuar njohjen e infrastrukturës ekzistuese dhe disponueshmërinë e komunikimit në rrjetet lokale të komunikimit operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist të zgjidhjeve infrastrukturore të teknologjisë së informacionit, nga një certifikues i njohur.”

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, Operatori Ekonomik ka paraqitur në spe:

- ✓ Certifikatë nga UDEMY “Windows Server 2019 Administration” për z. Stiven Toska
- ✓ Certifikatë “ AWS Certified Solutions Architecht-Associate” për z. Stiven Toska

Nga verifikimi i përputhjes së certifikatës me kriterin e kërkuar nga site online, rezulton se “AWS (Amazon Web Services) Certified Solutions Architect” është ndër certifikatat më të vlefshme dhe më të kërkuara të platformës cloud. Ky trajnim është projektuar për certifikimin e arkitektit të platformës kompjuterike cloud, për këdo që kërkon të mësojë komponentët kryesorë të Shërbimeve të Uebit të Amazon (AWS). AWS Certified Solutions Architect - Associate është një kategori certifikimesh teknike të ofruara nga Shërbimet Ueb të Amazon (AWS) për fillestarët dhe profesionistët që drejtojnë programe të arkitekturës së ndërmarrjeve, si dhe arkitektë zgjidhjesh. Ai mbulon vendosjen e sistemeve AWS, praktikat më të mira AWS dhe shumë tema të tjera.

Linke referues:

https://acloudguru.com/course/aws-certified-solutions-architect-associate-saa-c02?utm_campaign=11853653267&utm_source=google&utm_medium=cpc&utm_content=486641337815&utm_term=&adgroupid=114678743225&gclid=EA1aIQobChMInZXrsr3R9QIVA-R3Ch1qGgZMEAAAYASAAEgLmC_D_BwE

<https://whatis.techtarget.com/definition/AWS-Certified-Solutions-Architect-Associate#:~:text=AWS%20Certified%20Solutions%20Architect%20%2D%20Associate%20is%20a%20category%20of%20technical,practices%2C%20and%20many%20other%20topics>

Ndërkohë, Autoriteti Kontraktor, në kërkesat teknike të Termave të Referencës, ka sqaruar se *“Sistemi do të hostohet në infrastrukturën ekzistuese, dhe do t’i vihet në dispozicion operatorit ekonomik fitues gjatë kohës së planifikimit për konfigurimet përkatëse.”*

Gjithashtu në fazën II të zhvillimit të sistemit, një nga detyrat specifike është pikërisht: *“Përcaktimi i nevojave të infrastrukturës ku do bëhet hostimi i bazës së të dhënave.”*

Nisur nga sa më sipër dhe referuar kriterit të vendosur nga AK, është kërkuar një punonjës i certifikuar si specialist i zgjidhjeve infrastrukturore të teknologjisë së informacionit, që të garantojë njohjen e infrastrukturës ekzistuese (fizike) ku do të hostohet sistemi që do të ngrihet si dhe të garantojë disponueshmërinë e komunikimit me rrjetet lokale të komunikimit. Pra, referuar sa më sipër, OE nëpërmjet disponimit të stafit të certifikuar sipas këtij kriteri, duhet të garantojë njohuritë e nevojshme për ofrimin e zgjidhjeve të kërkuara në infrastrukturë fizike (sikurse disponon autoriteti kontraktor) dhe jo në ambient Cloud të ofruar nga AMAZON si në këtë rast, apo dhe të ngjashme me të. Pra, duke qenë se certifikata e paraqitur, lidhet me zgjidhje infrastrukturore Cloud, nuk krijohet bindja dhe besueshmëria se përmbush kushtet e kontratës që lidhen me këtë kërkesë.

Gjithashtu, certifikata nga UDEMY “Windows Server 2019 Administration”, duke qenë se “UDEMY” nuk është certifikues i akredituar, sikundër është sqaruar hollësisht për kriterin 2.3.3. (c), nuk merret në konsideratë për përmbushjen e kriterit si më sipërcituar.

Sa më sipër, kriteri 2.3.3. (e) i Kapatitetit Teknik, nuk përmbushet nga OE **“3i-Solutions” sh.p.k**

III. Po në vijim të kriterit 2.3.3. të kapacitetit Teknik, është kërkuar:

“dh. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar me MCSA Windows Server 2016 ose ekuivalente të lëshuar nga certifikues të njohur për rrjetëzimin me DNS, DHCP, menaxhimin e adresave IP, administrimin e shërbimeve të domainit aktual të Active Directory.”

Operatori ekonomik ka paraqitur në spe:

- ✓ Certifikate “Microsoft Certified Microsoft Azure Administrator Associate” me nr.1027-5265 per z.Stiven Toska
- ✓ Certifikatë nga “Brainbench” në “VMware vSphere 5” nr.14288165

Nga AK është sqaruar rëndësia e këtij kriteri në procesverbalin e argumentimit të kriterëve në spe ku citojmë :

“Institucioni aktualisht ka një “Direktori Aktive” të zhvilluar nga Microsoft për rrjetet e domenit Windows. Kjo direktori është një strukturë hierarkike që ruan informacione rreth objekteve në rrjet dhe ofron metodat për ruajtjen e të dhënave të drejtorisë dhe vënien në dispozicion të këtyre të dhënave për përdoruesit dhe administratorët e rrjetit. Kërkesa që O.E të dëshmojë që ka në stafin e tij të paktën 1(një) specialist i certifikuar me MCSA Windows Server 2016 ose ekuivalente, shihet si e domosdoshme për të provuar zotërimin e aftësive për të administruar Windows Server, duke përfshirë instalimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të ruajtjes, Hyper-V dhe

kontejnerët Windows, rrjetëzimi me DNS, DHCP, menaxhimin e adresave IP, infrastrukturën e avancuar, dhe administrimin e shërbimeve të domenit të “Direktori Aktive” të sitemit të centralizuar të institucionit. DNS- është shkurtes per Domain Name System dhe qe bene perkthimin e emrave ne IP Adresa dhe anasjelltas. DHCP- është shkurtese per Dynamic Host Configuration Protocol qe është nje protokol i rrjetes qe mundeson konfigurimin automatik te paisjeve te rrjetes per komunikim ne rrjete.”

Nga verifikimi i certifikatës “Microsoft Certified Microsoft Azure Administrator Associate” të paraqitur për përmbushjen e kriterit 2.3.3 (dh), në site zyrtar rezulton se përgjegjësitë për këtë rol përfshijnë zbatimin, menaxhimin dhe monitorimin e identitetit, qeverisjes, ruajtjes, llogaritjes dhe rrjeteve virtuale në një mjedis cloud, dhe sigurimin, madhësinë, monitorimin dhe rregullimin e burimeve, kur nevojitet. Kjo certifikatë nuk rezulton se përmbush kushtet për *rrjetëzimin me DNS, administrimin e shërbimeve të domaint aktual të Active Directory*, sikurse është cituar në kërkesat e kriterit.

Gjithashtu, certifikata nga “Brainbench” në “VMware vSphere 5” për demonstrim të kompetencës tenike e platformave virtuale, duke përfshirë qendrat e të dhënave, ruajtjen virtuale dhe CPUs, nuk është ekuivalente e certifikimit të kërkuar dhe nuk siguron përmbushjen e kërkesave të kriterit të sipërpërmendur nga AK. .

Pra, OE nuk garanton AK se nëpërmjet disponimit të stafit të certifikuar si më sipër përmbush kërkesat e kësaj kontrate.

Sa më sipër, kriteri 2.3.3. (dh) i Kapatitetit Teknik, nuk përmbushet nga OE “3I SOLUTIONS” sh.p.k .

Si përfundim, KVO konstaton se operatori ekonomik “3i-Solutions” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin 2.3.3. (c), (e), (dh) të “Kapacitetit teknik”, si pjesë e kritereve të vecanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**INET ALBANIA**” shpk, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 27.686.000 (njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë është identifikuar si Oferta e Sukseshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.